

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



01

DIBËR, MBAHET PANAIRI I EDUKIMIT, TRAJNIMIT DHE PUNËSIMIT

Përgjatë vitit 2023, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët lançoi nismën "Panair Edukimi, Trajnimi dhe Punësimi në çdo qark", një nismë kombëtare në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, dedikuar të rinjve, informimit të tyre mbi mundësitë lokale dhe kombëtare, për t'ju lehtësuar hyrjen në tregun e punës. Në vijim të kësaj nisme, më 29 Janar, **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me Zëvendëskryeminstren organizoi panairin e radhës në qarkun e Dibrës për të prezantuar të rinjtë me programe dhe mundësi trajnimi e punësimi në sektorë të ndryshëm.** Mbi 30 aktorë që ofrojnë shërbime për të rinjtë, i njohën ata me mundësitë lokale dhe kombëtare në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashtruara nga të rinjtë.



02

LANÇOHET NISMA "TË RINJTË NË KOMUNITET", FILLOJNË KONSULTIMET PËR RISHIKIMIN LIGJIT "PËR VULLNETARIZMIN"

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përgjatë muajit janar ka lançuar nismën "Të rinjtë në komunitet", me qëllim nxitjen e angazhimit të të rinjve në komunitet për të rritur ndikimin e tyre pozitiv në shoqëri. Ndër të tjera, nisma "Të rinjtë në komunitet" synon përmirësimin e Ligjit "Për Vullnetarizmin", parashikuar gjithashtu në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, për të lehtësuar punën vullnetare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të kësaj nisme është mbajtur takimi i parë konsultues me të rinj, aktivistë dhe organizata mbi rishikimin e Ligjit "Për Vullnetarizmin", ku pjesëmarrësit kanë shprehur ide dhe propozime për përmirësimin e ligjit në shërbim të vullnetarëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



03

TË RINJTË QË FRYMËZOJNË 2023 - NDEROHEN ME ÇMIME 14 TË RINJ MODELE FRYMËZIMI

Më 25 janar, në kuadër të nismës "Të rinjtë që frymëzojnë", Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me Agjencinë Kombëtare të Rinisë organizuan një mbrëmje gala e cila bëri bashkë të rinj frymëzues nga e gjithë Shqipëria që shkëlqejnë në fusha të ndryshme dhe janë një shembull frymëzues për bashkëmoshatarët e tyre, por dhe për komunitetin në tërësi. Mbrëmja nisi me një performancë muzikore dhe kërcim modern nga një grup të rinjsh të kurorëzuar përgjatë vitit 2022 si "Të rinjtë e vitit". **Në mbrëmjen gala, e cila promovoi modele suksesi e të rinj të talentuar në fusha të ndryshme si arti, sporti, kultura, inovacioni, aktivizmin rinor dhe gjithëpërfshirja, si pjesë e nismës të vitit 2023, u kurorëzuan me çmimin "Të rinjtë që frymëzojnë" 14 të rinj dhe u certifikuan 40 të tjerë.**

Të pranishëm në event ishin dhe personalitete të tjerë si përfaqësuesit e UNICEF dhe UNFPA në Shqipëri dhe zëvendësministra përgjegjës për fushat e sportit, infrastrukturës, punësimit, por edhe të ftuar të tjerë të suksesshëm, të cilët ndanë çmimet për të rinjtë e nismës.



04

ZBATIMI I PROGRAMIT "EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA"

Për të monitoruar mbarëvajtjen e Programit "Ekipet Sportive në shkolla" dhe për të evidentuar impaktin e programit që po zbatohet për të dytin vit radhazi, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, **përgjatë muajit janar ka zhvilluar tre vizita monitoruese, përkatësisht në shkollën "Bashkim Fino" dhe "Dhora Leka" në Tiranë, dhe një vizitë në qytetin e Dibrës.** Në kuadër të këtij programi, fëmijët dhe të rinjtë janë pajisur me uniforma dhe bazën materiale të nevojshme, të siguruar këto të fundit nga Qeveria Shqiptare për mbarëvajtjen e programit. Fëmijët dhe të rinjtë zhvillojnë trajnime 3 herë në javën në disiplinën e volejbollit dhe basketbollit me trajnerë profesionistë.

Programi Ekipet Sportive në shkolla ka filluar zbatimin që prej vitit 2022 në të gjithë Shqipërinë. Për të dytin vit radhazi, janë angazhuar mbi 10,000 fëmijë dhe të rinj në të gjithë Shqipërinë, ndërkohë këtë vit për herë të parë po pilotohet projekti edhe për grupmoshën 8-10 vjeç, ku janë angazhuar rreth 1,000 nxënës.



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



05

ZBATIMI I PROGRAMIT "KODIMI NË SHKOLLA", NJË PRAKTIKË E SUKSESSHME PËR NXËNËSIT E KLASAVE TË PARA DHE TË DYTË.

Në kuadër të Programit të Kodimit në Shkolla, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një vizitë në shkollën "Dhora Leka" në Tiranë për të parë nga afër zbatimin dhe ecurinë e programit, si dhe impaktin e tij tek nxënësit. Gjatë vizitës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bisedoi me nxënësit që marrin pjesë në Programin e Kodimit në Shkolla, duke dëgjuar komentet pozitive të nxënësve për programin dhe entuziasmin e tyre teksa kalonin nivel pas niveli në platformën Code Monkey, e cila ndihmon në procesin e të nxënësve, zhvillimin e mendimit kritik dhe logjikës.

Kodimi në shkolla ka filluar zbatimin në vitin 2022. Aktualisht po zbatohet në klasat e para të 300 shkollave publike dhe 40 shkolla jopublike në Shqipëri. Ndërkohë, projekti po pilotohet për klasat e dyta në 100 shkolla në të gjithë Shqipërinë, të pajisura të gjitha me laboratorë inteligjentë. Mësuesit që japin lëndën e kodimit trajnohen rregullisht për të qenë të përditësuar më metodat e posaçme didaktike që kjo lëndë kërkon.



06

INAUGURIMI I SALLËS SË LEXIMIT NË BIBLIOTEKËN E DIBRËS

Në kuadër të mbështetjes të ofruar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ngritjen e infrastrukturës rinore, më datë 29 janar, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me Zëvendëskryeminstren mori pjesë në inaugurimin e sallës së leximit të bibliotekës në Dibër, realizuar nëpërmjet thirrjes së dytë Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Qytetit të Dibrës tashmë i është shtuar një ndër ambientet më të reja dhe me vlerë për të rinjtë libërdashës, që u hap dyert drejt dijes, dhe plot aktiviteteve kulturore që nxisin ndërveprimin e të rinjve me njëri-tjetrin.



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



07

ZBATIMI I PROJEKTEVE RINORE NGA THIRRJET E AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

Në kuadër të zbatimit të dy projekteve rinore nga thirrja e tretë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në konsultimet e mbajtura si pjesë e projektit "Një ndalesë për shërbime rinore të integruara në Qarkun Korçë", me qëllim evidentimin e çështjeve të cilat kanë nevojë për mbështetje institucionale për t'u zgjidhur.** Rreth 60 të rinj e të reja të Qarkut Korçë dhe anëtarë të Këshillave Vendor Rinor, filluan me përgatitjet për Planet Vendor Rinore, ku për 4 orë punuan për të evidentuar sfidat me të cilat përballeshin të rinjtë, si dhe zgjidhjet që propozojnë për secilën bashki. Pas prezantimit të çështjeve shqetësuese për të rinjtë e Qarkut Korçë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët vuri në dukje se ndryshe nga konsultimet për Strategjinë Kombëtare të Rinisë, tashmë janë evidentuar sfida të reja, duke treguar se strategjia ka adresuar nevojat e të rinjve, por me zhvillimin e vazhdueshëm duhen zgjidhje efikase dhe afatgjatë për sfidat e reja.

Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në trajnimin e parë të zhvilluar për 30 të rinj në kuadër të projektit "Re-Debate", Kampionati Kombëtar i Debatit, i cili po zbatohet në 48 qytete nga organizata Liburnetik. Trajnimi u përqendrua në teknikat e argumentimit efektiv dhe strategjitë e komunikimit, dhe nxiti 30 të rinjtë të angazhoheshin që ditën e parë për të realizuar debate sipas rregullave të veçanta që mësuuan në trajnim prej të cilave më kryesorja është "Përdorni fjalë të buta dhe argumente të forta".

Projekti "Një ndalesë për shërbime rinore të integruara në Qarkun Korçë" dhe "Re-Debate" mbështeten nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe financohen nëpërmjet thirrjes së tretë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

08

MBAHET MIQËSORJA E PARË E REGBISË SHQIPËRISË DHE KOSOVËS NË KUKËS ARENA



Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në miqësoren e regbisë mes Shqipërisë dhe Kosovës të zhvilluar më 15 janar në Kukës Arena. Synimi i këtij bashkëpunimi midis Kosovës dhe Shqipërisë përveç shkëmbimit të eksperiencave, është edhe nxitja e përhapjes së gjerë e këtij sporti në të dy shtetet dhe krijimi i ekipeve kombëtare edhe për femrat. Sporti i regbisë synohet të nxitet edhe më shumë tek fëmijët dhe të rinjtë, pasi ai u mëson disiplinën e të qenurit një ekip, forcon aftësitë e tyre për t'u kujdesur për shëndetin dhe për të qëndruar larg të gjithë veseve që mund të marrin po të mos angazhohen në sport.



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRIVEMINISTRIA
MINISTRI I SHITIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Janar



09

SHPALLEN DY PROJEKTET FITUESE TË UPSHIFT PËR "CILËSINË E AJRIT" NË QYTETIN E SHKODRËS

Në qytetin e Shkodrës, për tre ditë radhazi të rinjtë e angazhuar në UPSHIFT për "Cilësinë e Ajrit", të ndarë në 10 grupe kanë punuar mbi problematikat mjedisore të evidentuara në komunitetin e tyre, duke u nisur nga rrënja e problemit, rruga për ta zgjidhur e deri tek konceptimi i një projekti që i jep zgjidhje këtyre problemeve dhe përmirëson cilësinë e ajrit. **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, si një nga mbështetësit e këtij UPSHIFT për "Cilësinë e Ajrit", i dorëzoi çmimin prej 1,000 Euro njërit prej dy grupeve fitues. Financimet për dy ekipet fituese do të shërbejnë për implementimin praktik të ideve të rinjve të konkretizuara tashmë në një projekt të mirëfilltë.**



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRIMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT